



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

Mbledhja nr. 33/2018

Prishtinë, më 26.6.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Liburn Aliu, Hykmete Bajrami, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Mimoza Kusari – Lila, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

**Prezent:** Salih Zyba, deputet nga GP LVV.

**Të ftuar:** Mërgim Lushtaku, deputet nga GP PDK; Faton Thaçi, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë; Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Durim Limaj, Rexhep Billaca, Arber Muhaxheri - MTI; Avdi Kamerolli-MI; Bajram Zejnullahu, Ekrem Hajdari - AKP; Dardan Abazi - INDEP; Qëndrim Badalli - KDI dhe Liridon Gashi - SEEF.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur 21.6.2018;
- 3.Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020)”;
- 4.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;
- 5.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2017;
- 6.Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja** propozoi që pika e tretë: “Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020)”, të kalojë në pikën e katërt, ndërsa, pika e katërt “Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete,” të kalojë në pikën e tretë të rendit të ditës, pasi që është kërkesë e deputetit z. Mërgim Lushtaku, propozuesin e Projektligjit.

*Rendi i ditës u miratua më ndryshimin e propozuar.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.6.2018**

*Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 21.6.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete**

**Sala Berisha-Shala, kryetare** tha që kjo nismë ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete, është marrë nga deputeti Mërgim Lushtaku, dhe gjitha procedurat i ka kaluar tani në, si Komision funksional, jemi të ngarkuar ta shqyrtojmë. Ia kaloi fjalën z. Lushtaku, për të arsyetuar iniciativën ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete.

**Mërgim Lushtaku** tha se arsyeja pse e ka marrë këtë nismë ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete, është sepse ka mjaft ankesa nga qytetarët për shkak të standardit që është mjaft i ulët për të pajisur më vetura të reja, që kanë dalë nga prodhimi në 10 vitet e fundit. prandaj, kërkoi që të hiqet ky kufizim. Pastaj i prezantoi ndryshimet: në nenin 44 të Ligjit bazik, paragrafët 2. dhe 3. shkrihen në një paragraf si vijon: në Kosovë nuk mund të importohen dhe nuk mund të qarkullojnë vetura të cilat nuk e plotësojnë standardin minimal Euro katër (4); në nenin 63 të Ligjit bazik, paragrafët 1. dhe 2. riformulohen si vijon: Ç lajmërimi i mjetit për shkak të ndërrimit të pronarit është i mundur vetëm nëse në të njëjtën kohë regjistrohet pronari i ri i mjetit në evidencë dhe bartet pjesa e mbetur e regjistrimit të mjetit; në nenin 89 të Ligjit bazik, paragrafi 3. të ndryshohet si vijon: Kontrolli teknik i mjeteve mund të bëhet vetëm brenda Republikës së Kosovës ku ka subjekte për kontroll teknik. Në fund kërkoi nga komisioni të mbështetet kjo dhe kërkoi që të ftohet në takime të komisionit dhe grupit të punës pas miratimit në parim.

**Kryetarja** tha se më të drejtë është paraqitja e shqetësimeve të qytetarëve, konsideroi që vjetërsia e automjeteve nuk është shkak i ndotjes së ambientit siç po pretendohet të paraqitet, por cilësia e dobët e naftës dhe në edhe në aspektin e kontrollit të automjeteve është i nevojshme ndryshimi i kritereve për të mos lejuar qarkullimin e automjeteve me defekte teknike.

**Avdi Kamerolli, përfaqësuesi nga Ministria e Infrastrukturës** tha që ndryshimi i neneve 44, 63, 89, është i pa nevojshëm dhe i pa arsyeshëm për Ministrin e Infrastrukturës, ndryshimet e propozuara krijojnë mundësi për çrregullim të tregut të importit të automjeteve, të cilat janë në dëm të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe të shëndetit të qytetarëve në përgjithësi. Këto ndryshime ligjore Kosovën e shndërrojnë në një varrezë të automjeteve të vjetra të kalbura të cilat e ndotin ambientin, ku siguria pasive dhe aktive është e mangët. Përderisa Komisioni Evropian inkurajon shtetin e Kosovës për të futur në treg automjete ekologjike që nuk e ndotin ambientin, kjo iniciativë ligjore është në kundërshtim me rekomandimet e Komisionit Evropian. Aplikimi i rregullit që qytetarët të bëjnë kontrollimin teknik brenda një komune, është një instrument rregullues i përshtatshëm që i kontribuon rregullsisë së automjeteve si pjesëmarrëse në komunikacion, ka liberalizim të tregut dhe konkurrencë brenda një komune për subjektet që merren me kontrollimin teknik të automjeteve.

**Hykmete Bajrami** tha sa i përket këtij nenit 44 për heqjen e kriterit të vjetërsisë së veturave, konsideroj se na duhet një analizë pak më e detajuar për me parë me të vërtetë se a janë dëmtuar qytetarët, sa është ulë numri i veturave të vjetra. Mendojë se një kriter i tillë ka pasur ndikim pozitiv qoftë në mbrojtjen e ambientit, qoftë në ndryshimin e komplet të veturave. Ajo tha se është për ndryshimin e nenit 63 për procesin e regjistrimit të automjeteve, pasi që sigurimi i regjistrimit po i bije të paguhet dy herë pas shitjes së automjetit dhe ndërrimit të pronarit.

**Dardan Sejdiu** tha së gjatë fazës së amendamentimit deri në leximin e dytë këto propozime duhet t'i shqyrtojmë dhe analizojmë mirë. Ngriti çështjen e statistikave për cilësinë e kontrollit teknik që bëhet në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve. Prandaj këto duhet të bëhet kufizimi i cilësisë dhe jo kufizimi kohor.

**Liburn Aliu** tha se kriteri kufizimit të vjetërsisë për import të automjeteve duhet me pasur mekanizmat e vet që këto vetura të kontrollohen mirë në aspektin teknik për të mos pasur defekte. Ai theksoi se një veturë mund të jetë e vjetër, por ndoshta i plotëson kriteret dhe standardet për vozitje të mirë. Andaj mekanizmi kohor si kriter nuk duhet të jetë i kufizuar në ligj, por kriter duhet të jetë kontrolli teknik i automjetit.

**Bilall Sherfi** tha se kemi krijuar instrumente universale, prandaj duhet t'i ngritim kapacitetet administrative dhe teknike përmes mekanizmave të kontrollit teknik të automjeteve në mënyrë që mos e kemi vetëm arsyetimin e kufizimit të vjetërsisë së automjeteve.

**Mergim Lushtaku** theksoi se edhe në aspektin e kontrollit të automjeteve ka shkelje të konkurrencës së lirë, për mendimin tim, kjo është plaçka që iu bëhet qytetarëve. Nuk desha me shpreh më herët këtë çështje, por me të vërtetë është plaçkë kur dikush e ka një veturë, e regjistron, edhe pastaj dëshiron me ia shitur një pronari tjetër, e ai pronarë duhet të paguajë prej fillimit regjistrimin e veturës dhe kontrollin teknik, këto mjete as nuk i kthehen pronarit të vjetër dhe as nuk i barten pronarit të ri. Kështu që ne, si deputet, për çdo ditë gjatë takimit me qytetarë, ata i shprehin këto brenga, por sigurisht se edhe për neve është shqetësuese, mirëpo për Qeverinë duhet me qenë edhe më shqetësuese.

**Kryetarja** tha se neve, si komisionin, mund ta organizojmë edhe një dëgjim publik për t'i ballafaquar të gjitha palët për dhe kundër për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete.

*Pas debatit, komisioni unanimitet nxori këtë:*

*Përfundim*

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020)**

**Sala Berisha-Shala, kryetare,** theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës e kemi të ftuar zëvendësministrin e Tregtisë dhe Industrisë z. Faton Thaçi, të cilit ia kaloi fjalën për të paraqitur në parim projektligjin

**Faton Thaçi, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë,** para komisionit e arsyetoi projektligjin në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Programi COSME i Komisionit Evropian është programi i Bashkimit Evropian për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme për vitet 2014 - 2020, financuar nga Këshilli Evropian dhe menaxhuar nga Agjencia Ekzekutive për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (EASME) me një buxhet prej 2.5 miliardë eurove prej të cilave 60%, apo mbi 1,3 miliardë euro, janë të dedikuara për instrumente financiare. Objektiva thelbësore e COSME-s është të mbështesë NVM-të të cilat, në mungesë të COSME-s, nuk do të kishin qasje në financa, pra financim me risk financiar më të lartë. COSME mbështet: i) qasje më të mirë në financa për NVM-të, qasje në tregje për NVM-të, ndërmarrësin dhe kushte më të favorshme për krijimin dhe rritjen e ndërmarrjeve. Qasja në Financa, një nga objektivat kryesore të COSME-s është të afrojë qasje më të madhe në financa për NVM-të në faza të ndryshme të ciklit të zhvillimit të tyre: krijimi, zgjerimi ose transferimi i biznesit. Për të arritur këtë objektiv, BE mobilizon kredi dhe investime të kapitalit për NVM-të. Qasja në Tregje COSME afron mbështetje për ndërmarrjet evropiane dhe, në këtë rast, edhe ato kosovare, që të përfitojnë nga tregu i bashkuar i BE-së dhe të përfitojnë sa më shumë nga mundësitë që afrojnë tregjet jashtë BE-së. Inkurajimi i Ndërmarrësisë COSME mbështet implementimin e Planit të Veprimit për Ndërmarrësinë 2020 përmes një game të gjerë aktivitetesh. Këto përfshijnë shkëmbimin e mobilitetit, hulumtimin, shpërndarjen e praktikave më të mira dhe pilot-projektet në fusha të tilla si arsimimi mbi ndërmarrësin, monitorimi ose zhvillimi i shërbimeve udhëzuese dhe mbështetje për ndërmarrësit e rinj dhe potencialë, duke përfshirë ndërmarrësit e rinj, gratë ndërmarrëse dhe ndërmarrësit e moshuar. Krijimi i Kushteve më të Favorshme për Konkurrueshmëri. Prandaj, ne besojmë dhe jemi plotësisht të bindur që lidhja e kësaj marrëveshjeje do të rrisë qasjen në financa për NVM-të, qasjen në tregje dhe inkurajimin e ndërmarrësisë dhe krijimi i kushteve më të favorshme për konkurrueshmëri dhe ju ftoj që ta e miratoni këtë projektligj dhe ta procedoni tutje për miratim në Kuvend.

**Dardan Sejdiu** pyeti cili është mekanizmi që keni bërë përzgjedhjen e ndërmarrjeve? Cili ka qenë kriteri i klasifikimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe mbi çfarë bazë e keni bërë këtë marrëveshje?

**Rexhep Bllaca, nga Ministra e Tregtisë dhe Industrisë,** tha që në mekanizmin e përzgjedhjes së ndërmarrjeve kemi marrë dy kritere: kriterin e numrit të punësuarve dhe kriterin e qarkullimit financiar të ndërmarrjes. Ne ju kemi dhanë prioritet ndërmarrjeve që e kanë marrë për bazë më shumë kriterin e të punësuarve për ta rritur nivelin më të madhe të punësuarve.

**Dardan Sejdiu,** cili është numri i të punësuarave në ndërmarrjet e vogla dhe mesme dhe a keni qasje në fondin e financimit?

**Rexhep Bllaca, Ministra e Tregtisë dhe Industrisë,** tha numri punëtorëve në ndërmarrjet të vogla është deri 49 dhe prej 50 deri 249 është në ndërmarrjet e mesme, tha që ligjërisht në çdo ndërmarrje të vogël dhe e mesme janë përdorur mekanizmat në bazë të kriterëve.

**Durim Limaj, nga Ministra e Tregtisë dhe Industrisë,** tha që mekanizmi është që do të krijohet një Këshill që do të bëjnë përzgjedhjen e ndërmarrjeve, ky është një qëllim që ndërmarrjet tona më pas qasje në Bashkimin Evropian.

**Hykmete Bajrami** tha që krijimi i një mekanizmi që do të ju ndihmonte ndërmarrjeve më shumë është që duhet t'i paraqesin pasqyrat financiare të audituara. Ideja ka qenë që MTI-ja të krijojë një komision këshillëdhënës që do t'i këshillonte ndërmarrjet për të përfituar nga ky program në COSME.

**Faton Thaçi, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë** tha që ne do ta kemi një ekspert që do ta angazhojmë për t'i ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe mesme në këshillime për përfituar nga programi COSME-s.

**Kryetarja** tha që në këtë rast procedurat janë që të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare shkojnë më një lexim në Kuvend dhe votohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Po ashtu, kërkoi që të behet një amendament teknik, ku në titullin e Projektligjit, fjalia “KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014-2020)” zëvendësohet me “KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014-2020)”, dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit sepse projektligji duhet të jetë në harmoni më marrëveshjen.

*Komisioni e përkrahu propozimin-amendamentin e kryetares.*

*Pas debatit, komisioni unanimisht nxori këtë:*

*Përfundim*

- 1. Të miratohet Projektligji nr.06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020)”, me amendamentin e miratuar;*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha- Shala, kryetare e Komisionit.*

## **5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2017**

**Kryetarja** theksoi se raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit e kemi marrë me kohë dhe sipas procedurës sot e kemi në shqyrtim në Komision. Kryetarja falënderoi institutin INDEP për analizën që ka bërë për këtë raport. Në vazhdim ajo parashtrroi disa pyetje për përfaqësuesit e AKP-së, cili është përfundimi dhe kur planifikon AKP-ja të përfundon punën e saj? Pse nuk janë paraqit në listë ndërmarrjet e pa privatizuar dhe në cilat zona gjenden këto ndërmarrje? Dhe cilat ndërmarrje priten të privatizohen gjatë viti 2018? më hyrjen në fuqi të Ligjit për Trepçën a është bërë studimi i fizibilitetit të aseteve që kanë qenë në AKP?

**Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit** tha që AKP-ja në vitin 2017 ka pas një prej viteve më të suksesshëm, më arritjen e ndryshimit të Ligjit për Agjencisë Kosovare të Privatizimit i është dhënë mundësia që privatizimi të zhvillohet më procedura më të përsheptuar. Pas funksionimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e parë në përbërjen e re të miratuar ditë më parë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, bordit ka marrë vendime të rëndësishme konkretisht, Agjencia ka vendosur që të transferojë në buxhetin e Republikës së Kosovës mbi 42 milionë euro të kualifikuara si fonde të mbetura pas përmbushjes së kërkesave kreditore dhe pjesën tjetër të mbetur më konsultim më Ministrinë Financave do t'ia transferojmë në buxhetin e vendit të Kosovës. Në vitin 2016 AKP-ja e ka sjellë një plan program në Kuvend dhe konkretisht në Komision se si shih përmbylljen e procesit të privatizimit në formën e vet, por që në shumë raste nuk varet nga AKP-ja. Në web-faqen e AKP-së e kemi numrin e shtijës së aseteve që i kemi në privatizim që mund të gjenerojnë shumë të hyra, por që po kemi problem më sigurimin dokumentacionit nga Agjencia Kadastrale. Ne kemi aprovuar një plan për vitin 2018, por që shkak i mos kompletimit të Bordit të AKP-së për këtë vit e kemi reduktuar. Tani kemi paraparë vetëm 5 valë të privatizimit pasi që kanë mbetur 6 muaj për këtë vit. Më aprovimin e Ligjit nga Kuvendi për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit besojmë në rritjen e kapaciteteve të shqyrtimit të shumë lëndëve që i ka AKP-ja. Për Ligjin për Trepçën në kemi bashkëpunuar për moratoriumin që e kemi pasur për Trepçën, por më hyrjen në fuqi të Ligjit për Trepçën ne kemi reduktuar asetet shitjes dhe asnjë aset nuk do të hyje në likuidim pa shikuar së çfarë trajtimi do t'i behët këtyre aseteve. Ai theksoi se tani pasi zgjedhjes të Bordit mbikëqyrës të Trepçës kemi pezulluar çfarëdo aktiviteti që ka të bëjë më Trepçën dhe Raporti i AKP-së për studimin fizibilitetit iu është dorëzuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që është përgjegjës për Trepçën.

**Ekrem Hajdari, Agjencia Kosovare të Privatizimit**, i paraqiti të arriturat e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017. Tha që numri i shitjeve të aseteve në valët e privatizimit për vitin 2017 tregon suksesin që ka pas AKP-ja në vitin 2017 kemi pasur 1000 shitje të aseteve për këto kemi marrë 2000 aferta është arritur mesatarja e shitjes së tokave nga 35 deri në 350 euro. Kemi liruar asete e uzurpuara në veri të Mitrovicës, të inkasimi i qirave në shumë pika kemi arritur ta rrisim nivelin e inkasimit të qirave. Ai tha se kemi shtrirje dhe përfaqësim jashtë vendit në vendet e rejonit kemi identifikuar 38 asete në shtetet e rajonit si në: Maqedoni, Mali të Zi, Bosnje dhe Serbi, dhe jemi duke e bërë një plan veprimi për gjitha asetet në rajon për t'i identifikuar.

**Duda Balje** tha që e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017 dhe në komunën e Prizrenit ka pasur disa kërkesa për privatizim që janë realizuar dhe duke u realizuar më suksese dhe jemi të kënaqur më punën e AKP-së.

**Bilall Sherifi** pyeti së përmes cilëve mekanizma keni arritur të i identifikoni 38 asete jashtë vendit? dhe sa janë të shpenzimet e buxhetit të AKP-së në rroga?

**Liburn Aliu**, pyeti për numrin e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore a është i saktë dhe pse nuk janë evidentuar më herët këto asete cili ka qenë problemi? Për çështjen e identifikimit të ndërmarrjeve shoqërore jashtë vendit cili është plani i AKP-së për ta intensifikuar këtë çështje?

**Sali Zyba** kërkoi sqarime lidhur më vlerën 42 milionë euro se nga cila kategori janë transferuar? Dhe pse është bërë revidimi i planit të punës për vitin 2018?

**Hykmete Bajrami**, për çështjen e aseteve të uzurpuara, pasi blerësit po i privatizojnë po tërhiqen pse po ndodh kjo situatë? E kemi rastin e një lokali në sheshin e Prishtinës që është Telekom i Kosovës, pse nuk po i lirohet pronarit të vërtetë që ka ble këtë lokal?

**Dardan Sejdiu** pyeti se në çfarë të dhëna kadastrale bazoheni për asetet të cilat vendosin më shit në valë te privatizimit?

**Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit**, iu përgjigj pyetjeve: për përcaktimin identifikimit të aseteve jashtë vendit e kemi të zhvilluar në AKP përmes mekanizmave të ndryshëm dhe të palëve të treta, njoftohemi se asetet mund të jenë pjesë të ndërmarrjeve të caktuara; për buxhetin e AKP-së, tha së është mbi 7 milionë euro që shpenzohet në disa kategori. Për transferin e 42 milionë euro, tha që janë nga fondet e mbetura nga shitja e aseteve, pasi që janë trajtuar gjithë kreditorët; revidimi i planit të punës, tha që është bërë për shkak të mungesës së Bordit për 6 muaj dhe nuk kemi pasur kuorum më marrë vendim dhe tani kemi lënë vetëm 5 vale të privatizimit; për uzurpimet, tha që kemi pas problem më ish-uzurpatorët dhe më këto raste po merret edhe Policia; për çështjet e kompletimit të dokumenteve kadastrale, tha që kemi bashkëpunim më komunat për të na shërbyer përmes drejtorive kadastrale.

**Ekerm Hajdari, Agjencia Kosovare të Privatizimit**, iu përgjigj pyetjeve: për numrin e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, tha që në faqen 14 të raportit janë të përfshira në formë të grafikut gjitha kontratat që priten të finalizohen për shitjen e aseteve dhe pse nuk kanë qenë me herët në listën e shitjes së AKP-së këto ndërmarrje, tha se kanë qenë nën administrimin e dikujt tjetër dhe janë gjykatat që munden më përshpejtuar këtë proces dhe kemi përpiluar një plan më të dhënat historike të ndërmarrjeve shoqërore; për lirin e lokalit që ka telekom më qira, tha që AKP-ja deri më tani nuk ka mundur ta bëjë dorëzim pranimin te pronari sepse është në proces gjyqësor.

**Liburn Aliu** kërkoi sqarime nëse është rritur numri i aseteve dhe sa priten të dalin në listën përfundimtare si të reja? Ndërsa listat më të dhënat në aspektin kadastral mund t'i gjeni edhe më të dhënat tekstuale përmes komunave. Ai tha që AKP-ja duhet të planifikojë identifikimin e aseteve dhe identifikimi duhet të jetë prioritet i AKP-së.

**Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,** paraqiti dy çështje si sfida që po përballët AKP-ja dhe kërkoi nga komisionin adresimin e tyre: për Vendimin e Qeverisë për ndalimin e shitjes së gjitha tokave, tha që ky vendim nuk është i qartë sepse nuk specifikon së cilat toka nuk mund të privatizohen dhe deri tani e kemi respektuar këtë vendim. Çështja e dytë është te pronat e AKP-së që i menaxhon, Qeveria ka marrë vendim për me shpronësuar, por që asnjë pagesë nuk e ka bërë deri më tani nëse nuk bëhen këto pagesa, AKP-ja nuk mundet t'i shlyejë as pagesat që i ka ndaj kreditorëve dhe punëtorëve.

**Hykmete Bajrami** tha që vendimin e Qeverisë për ndalimin e shitjes së tokave nuk kam parë dhe është skandalozë që Qeveria më marrë vendim për një Agjenci që i raportin Kuvendit, dhe kërkoi që ky vendim t'i adresohet Komisionit dhe kryetarit të Kuvendit, dhe ne pastaj kemi mundësi ta trajtojmë. Ndërsa lidhur më shpronësimin pronave tha se Qeveria duhet të bëjë më kohe planifikimin e pagesave edhe këtë çështje duhet ta ngritim në rishikimin e Projektligjit për buxhet.

**Kryetarja** për këto çështje që u ngritën si sfida kërkoi, nga përfaqësuesit e AKP-së që t'i adresojnë dhe më shkrim, sa përket instruktuarës ligjore duhet të mos jetë pengesë puna e AKP-së, dhe për këtë do ta keni përkrahjen e Komisionit.

*Në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, komisioni nxori këtë:*

#### *Konkluzion*

*Shtyhet për mbledhjen e radhës votimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2017.*

## **6. Të ndryshme**

### **Çështjet vijuese**

**Mbledhja përfundoi në orën 13:30.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

-----  
**Sala BERISHA SHALA**